



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 02, datë 23.01.2020

**“MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE
NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK – NDIHMËN EKONOMIKE”**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 30/1, të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Socialenë Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM Nr. 597, datë 04.09.2019, kreu IV, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për Bllok-Ndhmën si më posht:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
 2. Familje me kryefamiljare gra, në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
 4. Familje me shumë fëmij.
 5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin universitetin.
 6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalid pune.
 7. Familje që kanë një anëtar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
2. Dokumentat e aplikuesëve të jenë sipas VKM-së Nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike".
3. Masa e Ndhmës Ekonomike të llogaritet sipas VKM-së Nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike".
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëher në datën e konfirmimit të bazueshmërisë ligjore, nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

Vendimi u miratua me 13 vota pro , vota kundër - s'ka ,vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI